



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.181/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Pro & CO Group”, Sh.p.k, me numër unik identifikues 811092254, me seli në Graçanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.P., me adresë në rr. “....” nr., Prishtinë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, rr. “Migjeni”, për shkak të anulimit të vendimit PSh. nr. 144/23 të datës 19.04.2023, dhe kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit PSh. nr. 144/23 të datës 19.04.2023, palëve ndërhyrëse Komuna e Prishtinës si autoritet kontraktues dhe OE “Sallahu”, në rivendosje sipas Aktvendimi të Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës K.DH.SHK.II nr.1488/23 të datës 16.11.2023, jashtë seancës, më datë 30.11.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET e bazuar kërkesa e paditësit “Pro & CO Group” sh.p.k,
- II. SHTYHET ekzekutimi i vendimit PSh. nr. 144/23 i datës 19.04.2023, i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për kërkesëpadinë.
- III. Caktohet seancë përgatitore me datë 20.12.2023 në ora 10:30.

A r s y e t i m

Historiku Procedural

Me datë 24.04.2023 Paditësi “Pro & CO Group”, Sh.p.k, me seli në Graçanicë, përmes përfaqësuesit me autorizim të tij, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit PSh. nr. 144/23 të datës 19.04.2023 të nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSh. nr. 144/23 të datës 19.04.2023, deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër nga gjykata.

Dhoma e Shkallës së Parë e kësaj Gjykate me Aktvendim të datës 19.04.2023 e ka refuzuar propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar si të pabazuar. Ndaj këtij Aktvendimi propozuesi ka parashtruar ankesë.

Me Aktvendim Kom. Dh.Shk.nr.801/2023 Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Dytë e ka aprovuar ankesën e propozuesit si të bazuar dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje në Dhomat e Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Dhoma e Shkallës së Parë e kësaj Gjykate me Aktvendim të datës 17.10.2023 e ka aprovuar propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar si të bazuar. Ndaj këtij Aktvendimi, e paditura OSHP, palët e interesuara Komuna e Prishtinës dhe OE “Sallahu” kanë parashtruar ankesë.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale K.DH.SHK.II nr.1488/23 me Aktvendim të datës 16.11.2023 i kanë aprovuar ankesën e të paditurës dhe ankesat e palëve të interesuara si të bazuara dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje në Dhomat e Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Veprimet e ndërmarra në rivendosje sipas vërejtjeve në Aktvendim të Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale K.DH.SHK.II nr.1488/23 të datës 16.11.2023.

Duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në Aktvendim të Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale K.DH.SHK.II nr.1488/23 të datës 16.11.2023, në procedurë të rishqyrtimit dhe rivendosjes Gjykata me Aktvendim të datës 20.11.2021, e konform nenit të LPK-së e ka aprovuar kërkesën e palëve të interesuara Komuna e Prishtinës dhe OE “Sallahu” dhe i ka pranuar si palë ndërhyrëse në procedurë.

Lidhur me vlerësimet e Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale *se aktvendimi i atakuar përmban shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nenit 181.1 dhe 182.2 pika (n), të LPK-së dhe shkelje thelbësorë të dispozitave të nenit 21 dhe 37 të LKA-së, për shkak se gjykata nuk ka ftuar palet e interesuara që kanë qenë të ditura ne padi, në kërkesë dhe arsyetimin e vendimit të kundërshtuar, për shkak se palët e interesuara nuk kanë qenë të përfshira dhe nuk i është dhënë mundësia që të jenë palë në shqyrtimin e çështjes në gjykatë,* Gjykata e shkallës së parë sqaron se palët ndërhyrëse kanë shprehur interesim për ndërhyrje vetëm pasi Gjykata e shkallës së parë kishte marrë Aktvendimin e datës 17.10.2023 për shtyrje të ekzekutimit.

Komuna e Prishtinës si palë e interesuar për ndërhyrje në anën e të paditurit të kërkesën e ka parashtruar me datë 19.10.2023, ndërsa OE “Sallahu” kërkesën për ndërhyrje e ka parashtruar me 09.11.2023. Ndërsa, sipas padisë dhe kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit përfundimtar të OSHP-së, e paditur/kundërshtues i masës ishte vetëm Organi Shqyrtues i Prokurimit. Gjykata e shkallës së parë sqaron se në asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet detyrim i gjykatës që *ex officio* ti ftoj palët në procedurë në bazë të rrethanave të ditura çoftë në padi apo në arsyetim të vendimit të kundërshtuar, sepse cilësinë e palës së paditur në procedurë e përcakton vet paditësi (sipas Nenit 265 paragrafi 1, të LPK-së), e po ashtu edhe palët e interesuara kanë të drejte të parashtrojnë kërkesë për ndërhyrje (konform nenit 271 të LPK-së). Mirepo në rastin konkret edhe pse para vendimit të datës 17.10.2023 (tani të anuluar) ishin marrë edhe dy vendime të tjera (po ashtu tani të anuluar nga shkalla e dytë) palët e interesuara asnjëherë nuk kishin parashtruar kërkesë për ndërhyrje, prandaj gjykata e shkallës së parë nuk kishte asnjë detyrim ligjor që me vetiniciativë e në kundërshtim me nenin 265 dhe 271 të LPK-së - ti ftoj palët në procedure.

Mirëpo pasi palët e interesuara kanë shprehur interesim për ndërhyrje të njëjtat janë pranuar si palë ndërhyrëse, dhe në rivendosje Gjykata e shkallës së parë ka vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në Aktvendim të Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale K.DH.SHK.II nr.1488/23 të datës 16.11.2023, e ka dërguar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të paditurës OSHP-së dhe palëve ndërhyrëse Komunes Prishtinës si autoritet kontraktues dhe OE “Sallahu”, dhe me aktvendim i ka ftuar palët që në afat prej shtatë (7) ditësh për ti paraqitur kundërshtimet e tyre në kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar.

Përgjigje në kërkesën e paditësit “Pro & CO Group”, Sh.p.k, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSh. nr. 144/23 të datës 19.04.2023 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, brenda afatit ligjor konform nenit 63 të LKA-së, dhe nenit 305 të LPK-se, ka parashtruar OE “Sallahu” SH.P.K.

Aktvendimit për përgjigjen dhe kërkesën e paditësit “Pro & CO Group”, Sh.p.k, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSh. nr. 144/23 të datës 19.04.2023, Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Komuna e Prishtinës Aktvendimin e kanë pranuar me datë 20.11.2023. Komuna e Prishtinës nuk kanë parashtruar përgjigje/kundërshtim në kërkesë. Organit Shqyrtues të Prokurimit kundërshtimin e ka parashtruar pas afatit ligjor me datë 30.11.2023, ndërsa afati i fundit ka qenë me dt. 27.11.2023.

Lidhur me vërejtjet e shkallës së dytë ku thuhet se *gjkata e shkallës së parë është e obliguar që t'ia dërgoj padinë në përgjigje...* duke u bazuar në dispozitën e nenit 37 par. 1 të LKA [nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas paragrafit 2 të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji, gjykata do t'ia dërgoj nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkangjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar] Gjykata e shkallës së parë sqaron se me vendimin e datës 17.10.2023 është vendosur vetëm për kërkesën e paditësit/propozuesit për caktimin a masës së përkohshme, siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit nr. 08/1-015 për Gjykatën Komerciale, në nenin 27 paragrafi 1, ku përcaktohet: **Jo më vonë se tre (3) ditë nga marrja e një kërkesë për masë të përkohshme** ose lehtësim tjetër urgjent, në përputhje me ligjet në fuqi, dhoma e shkallës së parë e konsideron dhe vendos për një kërkesë të tillë **pa dëgjim të palëve në seancë**. Pra nuk është vendosur për padi për tu zbatuar neni 37. Paragrafi 1 i LKA, prandaj janë zbatuar dispozitat e nenit 27 të LGJK si në të gjitha rastet e vendosura deri më tani në praktikën gjyqësore të Gjykatës Komerciale në procedurën për caktimin e masave të përkohshme.

Kërkesa e paditësit “Pro & CO Group”, Sh.p.k. për shtyrje të ekzekutimit të vendimit PSh. nr. 144/23 të datës 19.04.2023

Paditësi në kërkesën e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të lartcekur, lidhur me plotësimin e kushteve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit ka theksuar se caktimi i masës së sigurisë është i domosdoshëm për arsye se paditësi i shkaktohet dëm i padrejtë dhe vështirë i riparueshëm sepse me ekzekutimin e vendimit paditësi do të privohet nga e drejta për tu kualifikuar si operator i përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe se marrë parasysh kohën e gjatë të zgjidhjes së çështjes meritore në raport me fitimin e munguar kjo me siguri do të rezultonte në dëm të padrejtë pasi që paditësi do të privohej nga të hyra të ligjshme të cilat do të ndikonin në qarkullimin financiar që do të derivonin nga implementimi i projektit kapital për ndërtimin e rrugës A – pjesa e parë, sipas aktivitetit të prokurimit 616-22-7096-5-1-2. Lidhur me plotësimin e kushtit të dytë dhe të tretë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit ka theksuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, përkundrazi do të ishte pikërisht zbatimi i vendimit të kundërshtuar ai që do binte në kundërshtim të hapur me interesin publik sepse shkeljet procedurale që i kanë paraprirë marrjes së vendimit hyjnë në kategorinë e normave penale duke pas parasysh se OE Sallahu Sh.p.k. i shpërblyer me kontratë, ka kryer veprën penale Keqpërdorim dhe mashtrim me prokurim publik nga neni 415 i KPRK-së, çka automatikisht e bënë të papërshtatshëm dhe të papërgjegjshëm për këtë aktiviteti të prokurimit. Prandaj, dëmi që shkaktohet nga vendimi i kontestuar nuk prek vetëm paditësin por edhe

taksapaguesit dhe buxhetin e Komunës së Prishtinës me paratë e të cilëve është financuar projekti kapital për ndërtimin e rrugës A – pjesa e parë. Po ashtu ka theksuar se me termin palë kundërshtare nuk duhet nënkuptuar vetëm Komunën e Prishtinës si institucion apo zyra e prokurimit pranë AK por duhet kujtuar se kjo e fundit përfaqëson dhe përbëhet nga komuniteti i të gjithë banorëve të qytetit të cilët kanë të drejtë të kërkojnë që paratë e tyre të shfrytëzohen në mënyrë të ligjshme, të përgjegjshme, të ndershme dhe transparente. Në fund ka theksuar se procedura dhe shkeljet procedurale që i kanë paraprirë marrjes së vendimit të atakuar dalin përtej fushëveprimit administrativ dhe depërtojnë në fushëveprimin e normave penale dhe se OE i shpërblyer me kontratë ka kryer veprë penale andaj e bënë të papërshtatshëm dhe të papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Kundërshtimi i palës ndërhyrësë OE “Sallahu” lidhur me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit PSh. nr. 144/23 të datës 19.04.2023.

OE “Salahu”, ka parashtruar kundërshtim në kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit Vendimit nr. PSH 144/231 të datës 19.04.2023 të nxjerre nga Organi Shqyrtues i Prokurimit. Me arsyetim se vendimet e OSHP0-së janë obligative për të gjitha institucionet, palët mund të kërkojnë rishikimin e vendimit të OSHP-së por nuk mund të kërkojë shtyrja e ekzekutimit sipas nenit 119 të LPP-së.

Deklaron se procedura e prokurimit është zhvilluar në përputhje të plotë me parimet dhe dispozitat ligjore që i referohen prokurimit publik në Kosovë. Qëllimi primar i kërkesës se paditësit është shkaktimi i vonësave në përmbushje të kontratës, dhe në këtë mënyrë i shkaktohet dëm i drejtpërdrejt i pariparueshëm në interesin publik, dhe palëve të interesuara/kundërshtare. Paditësit nuk i shkaktohet dëm i pariparueshëm sepse mund të konsiderohet fare si pale e dëmtuar, pasi që proceduralisht nuk ka asnjë mundësi të jetë fitues i kontratës apo të realizojë ndonjë të drejtë, sepse i njëjti është i renditur në vendin e tretë.

Deklaron se nuk përmbushen kushtet kumulative të përcaktuara me nenin 22 par 2 të LKA-së. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të nr. 144/23 të OSHP-së është e kundërligjshme e bazuar në të dhëna krejtësisht të pa vërteta, tendencioze si e tillë duhet të refuzohet, për faktin se nuk paraqet gjendje reale e faktike duke tentuar të vëjë në lajthim edhe gjykatën. Për më tepër, e njëjta nuk është e mbështetur në asnjë prove apo dëshmi me të cilën do të vërtetohej se kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit është e ligjshme dhe e bazuar. OA “Sallahu” është shpallur i përgjegjshëm me çmimin më të lirë/favorshëm, prandaj paditësi nuk është

gjendjen për të realizuar ndonjë të drejtë në këtë proces tenderues, rekomandimi i paditësit për kontratë do të përbën shkelje të rënda ligjore/procedurale dhe të cilat t' i shkaktonin Buxhetit të Republikës së Kosovës humbje për afër 1 milion euro.

Edhe po që se i njëjti të ishte palë e dëmtuar, fitimi i humbur cilësohet dëm monetar i realizueshëm dhe i cili do të realizohej pa ndonjë vështirësi në rastet kur kemi të bëjmë me institucione shtetërore. Deklaron se mos respektimi i procedurave ligjore dhe shkelja e afateve të përcaktuara ka ndodhur pikërisht nga paditësi.

Andaj, paditësi nuk ka arritur të argumentojë se me ekzekutimin e vendimit do shkaktohej dëm i padrejtë dhe vështirësi të riparueshëm, pasi që i njëjti ka dështuar të paraqes dëshmi të besueshme që tregojn mundësinë që e drejta e pretenduar ekziston (fumos boni iuris), dhe se dyti, rreziku i menjehershëm për këtë të drejtë (periculum in mora), pasi që dëmi i cili vështirë do të riparohet mund të ndodhë vetëm nëse në të vërtetë e drejta e pretenduar ekziston.

Lidhur me plotësimin e kushtit se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik ka deklaruar se në rast të shtyrjes së ekzekutimit të vendimit të atakuar çënohet shëndeti dhe mirëqenia e qytetarëve, për shkak të kundërmimit dhe kanaleve të hapura në mungesë të kolektorit. Pasojat nga mos ndërtimi i një rruge e cilësohet edhe si arterie/nyje e cila do të ndikonte në mënyrë direkte në reduktimin e pritjeve dhe kolonave të gjata në Kryeqytet.

Në mungesën e provave përmes të cilave do të argumentonte kërkesën e tij, ka kaluar në deklarime të rreme diskredituese në emër të OE Sallahu SHPK duke etiketuar si kryes të veprës penale Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 par 1 të KPRK-së, pa asnjë vendim të gjykatës, pasi që në dosjen tenderuese janë dorëzuar dëshmitë e kërkuara mbi pranueshmerinë/përshtatshmërinë e operatorit "Sallahu " sipas nenit 65 të LPP-se, në të cilat nuk ka shënime se OE ka ndonjë dënim të gjykatës.

Lidhur me kërkesën ligjore se shtyrja nuk do të sillte ndonjë dëm të madh palet kundërshtare përkatësisht personit të interesuar ka deklaruar se gjithë procesi i prokurimit për Ndërtimin e Rrugës A, që nga inicimi e deri në përfundimin e saj është zhvilluar në pajtueshmeri të plotë me Ligjin për Prokurim Publik.

Pezullimi i aktiviteti të prokurimit për "Ndërtimin e rrugës A- pjesa e pare iniciuar nga Komuna e Prishtinës, deri ne vendosjen përfundimtare të gjykatës, do t'ia pamundësonte Autoritetit Kontraktues qe te realizoje këtë aktivitet të prokurimit veprim ky i cili po ashtu është edhe në kundërshtim me interesin publik. Pasi që kontraktorit te pergjegjshëm "Sallahu Shpk", ka bere te gjitha përgatitjet e fillimit te punimeve me mjete të saj ka filluar implementimin e saj qe nga data 27.04.2023 dhe ka realizuar mbi 140 ditë pune, ka pranuar ofertat e materialeve, ka lidhur marrëdhënie kontraktuale, ka bërë porositë dhe ka marre furnizimet e materialeve, dhe deri ne këtë periudhe sipas Situacionit te x-te ka realizuar punimet e Kontratës ne vlerën e përgjithshme prej 1,615,969.00 euro. Prandaj konsideron se nuk janë plotësuar kushtet ligjore dhe i propozon gjykatës që ta refuzoj së të pabazuar Kërkesa për shtyrjen e vendimit me numër PSH 44/23 të datës 19.04.2023.

Vlerësimi i gjykatës

Me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, gjykata ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: *“Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyrë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*. Po ashtu në paragrafin 6 përcaktohet se *“Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”* dhe nenit 27 par. 1 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale i cili përcakton se *“Jo më vonë se tre (3) ditë nga marrja e një kërkesë për masë të përkohshme ose lehtësim tjetër urgjent, në përputhje me ligjet në fuqi, dhoma e shkallës së parë e konsideron dhe vendos për një kërkesë të tillë pa dëgjim të palëve në seancë”*

Bazuar në nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik; c) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e paditësit të paraqitura në propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe vlerësoi se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që propozuesi e ka argumentuar me prova të besueshme faktin se ekzekutimi i vendimit do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohej, se shtyrja nuk është në kundërshtim me

interesin publik, si dhe faktin se shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë Odëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Gjykata vlerëson se pretendimi kryesor i paditësit "Pro & CO Group", Sh.p.k, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar që rezulton me shkaktimin e dëmit të pariparueshëm për paditësin, taksapaguesit dhe buxhetin e Komunes së Prishtinës është pretendimi se e paditura dhe autoriteti kontraktues kanë bërë shkelje të nenit 65 të Ligjit (Nr.04/L-042) për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP), duke shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik "Sallahu" Sh.p.k. për ndërtimin e rrugës A – pjesa e parë, sipas aktivitetit të prokurimit 616-22-7096-5-1-2, Drejtori i të cilin është i dënuar për veprën penale Falsifikim i Dokumentit Zyrtar nga neni 398 par.2 të KPRK-së. Përkundër faktit të ditur për veprën e kryer, dhe njohurive se OE "Sallahu", ka nënshkruar *deklaratën nen betim mbi përshtatshmërinë* me rastin e aplikimit për tender. Kërkesës për shtyrje ia ka bashkangjitur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Krime të Rënda PKR. nr. 16/2018 të datës 30.03.2018.

Përderisa një pretendim të tillë OE "Sallahu" Sh.p.k e konsideron si deklaram të rremë dhe diskredituese ne emër të OE Sallahu SHPK duke etiketuar si kryes të veprës penale Keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik nga neni 415 par 1 te KPRK-së, pa asnjë vendim te gjykatës, me arsyetim se në dosjen tenderuese janë dorëzuar dëshmitë e kërkuara mbi pranueshmerinë/pershtatshmerine e operatorit "Sallahu " sipas nenit 65 të LPP-se, në të cilat nuk ka shënime se OE ka ndonjë dënim të gjykatës.

Ligji nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP) Neni 65 paragrafi 3 përcakton *Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara; është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin 1. të nenit 130 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare.*

Prandaj bazuar në nenin 63.3 të LPP-së, Gjykata vlerëson se pretendimi i ngritur nga paditësi “Pro & CO Group”, Sh.p.k, dhe i mbështetur në provë të besueshme Aktgjykimin e Gjykatës Themelorë në Prishtinë, Departamentit për Krime të Rënda PKR. nr. 16/2018 të datës 30.03.2018, paraqet një çështje serioze që e vë në dyshim përshtatshmërinë e OE “Sallahu” Sh.p.k, për ndërtimin e rrugës A – pjesa e parë, sipas aktivitetit të prokurimit 616-22-7096-5-1-2. Gjykata vlerëson se është e domosdoshme që ky pretendim të sqarohet në procedurë gjyqësore në bazë të provave të administruara para realizimit të projektit. Sepse duke pas parasysh rëndësinë e vërtetimit të përshtatshmërisë së një operatorit ekonomik për t’ia besuar realizimi e një projekti me vlerë prej 8,479,801.66 Euro, të financuar me paratë publike, pa u vërtetuar një pretendim i tillë kaq serioz, dëmi që do të shkaktohej është në çdo aspekt i pariparueshëm dhe jo vetëm për paditësit, por e dëmton rëndë interesin publik sepse e vë në dyshim realizimin e tërë projektit.

Dëmi do të ishte vështirë i riparueshëm për paditësit-propozuesit sepse paditësi do të privohej nga e drejta për t’ju nënshtuar një procedure të ligjshme, transparente dhe pa diskriminim ndaj të gjithë operatorëve ekonomik në procesin e përzgjedhjes për realizim të aktivitetit të prokurimit. Në këtë mënyrë i njëjti nuk do të privohej vetëm nga përfitimet monetare por edhe nga mundësia e fitimi të përvojës profesionale në zhvillimin e aktivitetit të tij të rregullt ekonomik në një ambient ekonomik të besueshëm ku funksionon rendi publik dhe sundimi i ligjit.

Dëmi do të ishte vështirë i riparueshëm edhe për OE “Sallahu”, sepse i njëjti i ka filluar dhe i ka vazhduar punimet përkundër faktit që aktvendimet për masë të përkohshme – shtyrje të ekzekutimit nuk ishin bërë asnjë herë të plotfuqishme. OE “Sallahu” ka vazhduar me implementimin e një kontrate të kontestueshme duke realizuar punime dhe duke marrë edhe obligime kontraktuale pa marrë parasysh faktin se lidhur me pretendimet që e vënë në dyshim përshtatshmërinë e tij për realizimin e projektit është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore. Megjithatë, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar, gjykata vlerëson se vërtetimi i bazueshmërisë së pretendimeve në seancë gjyqësore, do ta vë të njëjtin në një pozitë më të sigurt në mënyrë që shpenzimet e bëra në realizimin e një kontrate të kontestueshme nuk do të jenë dëme vështirë të riparueshme dhe të pakompenzueshme për të. Prandaj vendosja e masës së përkohshme është edhe në dobi të OE “Sallahu”.

Gjykata po ashtu vlerëson se shtyrja e përkohshme e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar dhe pezullimi i aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi i Rrugës A – Pjesa e Parë”, me numër të

prokurimit 616-22-7096-5-1-2, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës, deri në shqyrtimin e pretendimeve të ngritura për shkeljet e pretenduara procedurale është më se i duhur që të ruhet interesi publik. Kjo po ashtu do të evitoj çfarëdo dyshimi për keqpërdorim të fondeve publike nga Autoriteti Kontraktues. Në të kundërtën realizimi i projekti para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor do të ndikonte negativisht në besimin e publikut lidhur me shfrytëzimin e fondeve publike nga Autoriteti Kontraktues.

Gjykata sqaron se shtyrja e përkohshme e aktivitetit të prokurimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nuk është as pengesë dhe as ndales për Ndërtimin e Rrugës A. Qëllimi i masës së përkohshme është pikërisht interesi publik në mënyrë që të vërtetohet se operatori ekonomik-realizues i punimeve është i përshtatshëm dhe i besueshëm se punimet do ti realizoj pa mashtrime, pa manipulime, duke përbushur në përpikëri zotimet dhe duke vepruar nën përgjegjësi ligjore.

Gjykata e vlerëson ta pa pranueshëm pretendim e OE “Sallahu” *se fitimi i humbur cilësohet dëm monetar i realizueshëm dhe i cili do të realizohej pa ndonjë vështirësi në rastet kur kemi të bëjmë me institucione shtetërore.* Një arsyetim i tillë është i papranueshëm pikërisht për faktin se kemi të bëjmë me institucion shtetëror, sepse gjykata ka detyrim ligjor dhe kushtetues që të ushtroj kontroll gjyqësor ndaj vendimeve të organeve administrative për të garantuar ligjshmëri në aktivitetet e prokurimit që paguhen me fondet publike. Në mënyrë që të siguroj që nga fondet publike me veprime të kundërligjshme të mos paguhet dyfishi apo trefishi që do të duhej të paguhej për realizimin e një projekti.

Gjykata rikujton parimet themelore të afirmuara në nenin 1 të LPP-së, për shfrytëzim në mënyre transparente, efikase dhe të drejtë të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke respektuar procedurat dhe detyrimet e përcaktuara nga të gjitha organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Parime këto fundamentale për mbrojtjen e interesit publik, për të siguruar përdorim të ligjshëm të fondeve publike, mbrojtje të drejtave të operatoreve ekonomik dhe respektim të kushteve ligjore nga zyrtarët institucional.

Pretendimin e OE “Sallahu” se paditësit Pro & CO Group”, Sh.p.k nuk konsiderohet fare si pale e dëmtuar, pasi që proceduralisht nuk ka asnjë mundësi të jetë fitues i kontratës apo të realizojë ndonjë të drejtë, sepse i njëjti është i renditur në vendin e tretë, gjykata mund ta

vlerësoj vetëm në bazë të administrimit të provave që gjenden në dosjen e tenderit. Por vlerëson se ky fakt nuk është me ndikim në vendosjen e masës së përkohshme.

Gjykata duke marrë në konsiderate se realizimi i Projektit për Ndërtimin e Rrugës A është në interes publik për mirëqenien e qytetarëve, prandaj që të mos prolongohet shqyrtimit i çështjes pa afat të caktuar, me këtë aktvendim e caktoj edhe seancën përgatitore për ta trajtuar me prioritet këtë çështje në mënyrë që çështja kontestuese të merr një epilog përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme. Sepse gjykata vlerëson se nuk është në interes publik realizimi i projektit pa shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar sepse e një gjë e tillë e vë tërësisht në dyshim realizimin e punimeve duke qenë që çështja esenciale është besueshmëria e OE punëkryes.

Prandaj, duke qenë se në mënyrë kumulative janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 22 par. 2 të LKA-së, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 22 par. 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.181/2023, datë 30.11.2023

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

